

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Specialist Jurist Operacional

Ne baze te ligjit te Agjencise te Trajtimit te Kredive dhe rregullores se saj

Kërkesat e veçanta për perzgjedhjen e kandidatëve :

- Të jetë shtetas shqiptar ;
- të ketë zotësi të plotë për të vepruar ;
- të mos jetë i dënuar me vendim të formës së presë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje ;
- të ketë kryer studimet e larta , ne Fakultetin Juridik ose Ekonomik
- të ketë pervoje pune me shume se 1 vit ne administraten publike ose në sektorin privat;
- të ketë njohuri të mira të paketës Microsoft Office;
- zoterimi i nje gjuhe te huaj perben avantazh
- të ketë aftësi të mira drejtuese,menaxhuese, raportuese, komunikimi dhe të punës në grup.

Përgjegjësitë

Detyrat e *Specialist Sektorit Juridik dhe Operacional* :

- Përgatisin praktikat ligjore për në gjykatë dhe në zyrat e përmbarimit me iniciativën e vet dhe sipas kërkesave të Drejtorit të Përgjithshëm dhe përgjigjen për dërgimin në afat dhe ndjekjen e procedurave deri në përfundim të ekzekutimit.
- Kthejnë përgjigje sipas afateve të përcaktuara nga titullari dhe në përputhje me ligjin, korrespondencës së ardhur nga jashtë dhe brenda institucionit.
- Bashkërendojnë dhe koordinojnë punën për trajtimin ligjor të debitorëve, sipas zonave që mbulojnë.
- Mbajnë dhe ndjekin evidencën operative të fazës së trajtimit ligjor për të gjithë debitorët, sipas zonave që mbulojnë, duke pasqyruar në të ndryshimet përkatëse rast pas rasti.
- Ndjekin me përgjegjësi ligjore proceset gjyqësore, ku ATK është palë, në të gjitha shkallët e gjykimit duke përgatitur, mbrojtjen e duhur, kërkesë paditë, ankimet, rekurset si dhe çdo procedurë tjetër që është në interes të institucionit.
- Ndjekin procedurat ligjore për kalimin në pronësi të ATK –së të objekteve sipas vendimit përkatës të Përmbaruesit Gjyqësor.

Procedurat e Përgjithshme të Aplikimit :

Aplikimi duhet të përmbajë:

- Kërkesë me shkrim
- Curriculum vitae
- Libreza e punes
- Dëshmi Penaliteti

Aplikimet duhet të dërgohen në zarf të mbyllur duke specifikuar pozicionin në adresën:

Agjensia e Tratjimit të Kredive

Njësia Administrative nr.5, Tiranë Rruga “Dora D’Istria”, Ndërtesa 22 Hyrja 1. Kodi 3771821017

Afati

Aplikimet pranohen nga data 07 Maj 2021 ora 12:00.Do të shqyrtohen vetëm ato aplikime që mbërrijnë brenda këtij afati. Pas vlerësimit të dokumentave vetëm kandidatët e suksesshëm do të ftohen për intervistë.